VENDIM
Nr. 26, datë 9.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, mori në shqyrtim, në datën 4.2.2014, në seancë plenare dhe në datën 18.3.2014, në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 56/28 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përfaqësuar nga avokati i shtetit z. Abaz Deda, me autorizim dhe znj. Alba Thoma, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Zanmir Hasa, Florenc Kola, përfaqësuar nga avokati Alban Alimema, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 10141, datë 27.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2078, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-991, datë 10.5.2013 të Gjykatës së Lartë;

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 239, datë 13.1.2012 “Lëshim urdhër ekzekutimi” për vendimin nr. 1014, datë 27.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese;

Pushimi i gjykimit të padisë së Zanmir Hasës, ndërhyrësit kryesor, Florenc Kolës dhe paditës Ministria e Mjedisit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 153, datë 31.7.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) i Bashkisë Tiranë ka vendosur: njohjen dhe kthimin ish- pronarëve të një godine 2-katëshe, një garazhi dhe të truallit ku është ndërtuar godina 2-katëshe, me sipërfaqe të përgjithshme 879 m^2.

2. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Tiranë në regjistrin hipotekor nr. 3229, datë 4.8.1995, si pasuria nr. 1/206 . Subjekti i interesuar Z.H. është trashëgimtar ligjor i njërit prej ish-pronarëve të kësaj pasurie (O.F.) dhe në rrugë gjyqësore është njohur si pronar i 2/4 pjesë të pasurisë përkatëse (vendimi nr. 43, datë 27.11.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë që ka njohur vendimin e huaj). Me vendimin nr. 1603, datë 10.3.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është njohur subjektit të interesuar, Z.H., e drejta për t’u shpërblyer nga kërkuesja për përdorimin e pjesës takuese të sendit në bashkëpronësi, duke vendosur detyrimin e kërkueses ta shpërblejë në masën 1.986.000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është bërë objekt ekzekutimi në Zyrën Përmbarimore Tiranë.

3. Me vendimin nr. 2874, datë 12.5.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pjesëtimin e sendit (pasurisë), duke e kaluar të gjithë në pronësi të subjektit të interesuar Z.H., si dhe detyrimin e këtij të fundit t’u paguajë dy ish-pronarëve të tjerë vlerën prej 2.483.392,51 lekë.

4. Në datën 11.12.2007 subjekti i interesuar Z.H., i ka shitur 1/5 pjesë ideale të sendit subjektit tjetër të interesuar F.K.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e investuar nga subjekti i interesuar Z.H., me vendimin nr. 10141, datë 27.12.2010, ka vendosur pranimin e padisë për kthimin e sendit dhe detyrimin e kërkueses t’i paguajë dëmshpërblim subjekteve të interesuara, përkatësisht Z.H. në masën 548.605 euro, për përdorimin e sendit për periudhën 5 shkurt 2004 – 11 prill 2010 dhe F.K., në masën 115.796 euro, për përdorimin e sendit për periudhën 11 dhjetor 2007 – 11 prill 2010.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2078, datë 13.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10141, datë 27.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Kërkuesja i ka kërkuar Gjykatës së Lartë pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 10141, datë 27.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Lartë (vendimi nr. 192, datë 11.5.2012).

8. Mbi rekursin e paraqitur nga kërkuesja, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-991, datë 10.5.2013, ka vendosur mospranimin.

9. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht ajo ka pretenduar se:

9.1 Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (nr. 10141) dhe Gjykatës së Apelit Tiranë (nr. 2078) kanë cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

për shkak të një analize të përciptë dhe vlerësimi jo objektiv të provave e fakteve në gjykim;

9.2 Është cenuar e drejta e aksesit, pasi gjykimi në apel është bërë në mungesë të kërkueses dhe të Avokaturës së Shtetit duke mos u respektuar dispozitat procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e gjykimit nga ana e gjykatës;

9.3 Vendimi i Gjykatës së Lartë (nr. 00-2013-991) ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor për shkak të mosparaqitjes së arsyeve të mospranimit të rekursit.

10. ***Subjektet e interesuara*** kanë paraqitur këto prapësime në lidhje me pretendimet e kërkueses:

10.1 Kërkuesja nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues si pasojë e mosshterimit të mjeteve juridike në dispozicion, për shkak të mosushtrimit të rekursit ndaj vendimit nr. 2078, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë;

10.2 Pretendimi për mosnjoftimin e datës dhe orës së gjykimit në apel është i pabazuar pasi njoftimi është bërë me shpallje pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

10.3 Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, në bazë të jurisprudencës kushtetuese, vendimi i Gjykatës së Lartë ka respektuar standardin e arsyetimit, ndërsa pretendimet në lidhje me analizën dhe vlerësimin e provave bien jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Për sa i përket gabimit në përcaktimin e shumës së dëmshpërblimit që i takonte subjektit të interesuar F.K., kjo nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor pasi kërkuesja, nëpërmjet mjeteve procedurale që parashikon Kodi i Procedurës Civile (KPC) mund ta kërkojë në çdo kohë korrigjimin e këtij gabimi.

II
Vlerësimi i Gjykatës

A) Për pezullimin e zbatimit të vendimit gjyqësor

11. Kërkuesja ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 239, datë 13.1.2012 "Lëshim urdhër ekzekutimi" për vendimin nr. 1014, datë 27.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese. Sipas saj, ekzekutimi i këtij vendimi i sjell dëme të rënda Buxhetit të Shtetit dhe e privon kërkuesen nga të gjitha të drejtat që ka fituar në lidhje me investimet e bëra prej saj.

12. Gjykata vlerëson se kërkesa për pezullimin e zbatimit të vendimit gjyqësor, objekt shqyrtimi, nuk gjen mbështetje në kërkesat e nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkese si të pabazuar.

B) Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit

13. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi nr. 10141, datë 27.12.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi nr. 2078, datë 13.10.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë, që e ka lënë në fuqi, janë rrjedhojë e një arsyetimi joligjor dhe e një analize të përciptë të provave e fakteve në gjykim. Sipas saj, nga ana e gjykatës nuk është bërë një vlerësim objektiv i të gjitha provave të administruara në gjykim dhe u është njohur subjekteve të interesuara e drejta e pronësisë mbi objektin aktual 3-katësh, me shtesa, ndërkohë që ata rezultojnë pronarë vetëm të objektit ekzistues 2-katësh, të njohur me vendimin e KKKP-së. Akti i ekspertimit, ku është mbështetur gjykata, sipas kërkueses, është i pasaktë, nuk sqaron vlerat apo referencat ku është bazuar eksperti për llogaritjen e vlerës së qerasë dhe nuk përcakton asnjë kompensim për investimet e kryera nga kërkuesja.

14. Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses, të parashtruara më sipër, Gjykata vlerëson se, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre, në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2014; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 47, datë 7.11.2011; nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 31, datë 5.7.2011 dhe nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për pasojë, bazuar në këto standarde, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses, në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit, për shkak të vlerësimit të provave gjatë gjykimit të çështjes, janë haptazi të pabazuara.

C) Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

17. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë pasi nuk

ka respektuar dispozitat procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Sipas kërkueses, nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate nuk është publikuar data dhe ora e gjykimit duke rezultuar në zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkueses. Gjithashtu, vendimi i gjykatës së apelit është marrë nëpërmjet një procesi të parregullt, për shkak të mosnjoftimit të Avokaturës së Shtetit, sipas nenit 79/a të KPC-së.

18. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Ajo i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 34 datë 3.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga rrethanat faktike, Gjykata vëren se kërkuesja ka qenë në mungesë gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku interesat e saj janë përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, e cila ka marrë pjesë në gjykim. Avokatura e Shtetit, sipas ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë (neni 5/b).

20. Nga fletëthirrjet e ndodhura në dosjen gjyqësore rezulton se kërkuesja është njoftuar rregullisht për të gjitha seancat e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për sa i përket gjykimit në apel, Gjykata konstaton se ajo ka pasur dijeni me shpallje, sipas dokumentit të listës së çështjeve të shpallura për gjykim të datës 19.9.2011, të ndodhur në dosjen gjyqësore. Në Gjykatën e Apelit Tiranë kanë paraqitur ankim si Avokatura e Shtetit, ashtu edhe kërkuesja, ndaj, në këto kushte, në vlerësimin e Gjykatës, kërkuesja nuk shkarkohej nga përgjegjësia për t'u interesuar pranë gjykatës së apelit për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Edhe në Gjykatën e Lartë interesat e kërkueses janë përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, e cila ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit.

21. Gjykata ka vlerësuar edhe se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011 dhe nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke pasur parasysh standardin e mësipërm dhe pas vlerësimi të procesit si një i tërë, Gjykata nënvizon se, në rastin konkret, kërkuesja ka qenë në dijeni të zhvillimit të gjykimit në apel, nëpërmjet shpalljes së datës 19.9.2011 dhe interesat e saj janë përfaqësuar në shkallët e tjera nga Avokatura e Shtetit. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, është haptazi i pambështetur.

Ç) Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

23. Në lidhje me vendimin nr. 00-2013-991, datë 10.5.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kërkuesja ka pretenduar se ky vendim nuk i përmbush standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor pasi në të nuk janë paraqitur arsyet e mospranimit të rekursit, por vetëm "mosekzistenca e shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i KPC-së".

24. Referuar këtij pretendimi, Gjykata rithekson qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e saj se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 6, datë 10.2.2014; nr. 34, datë 12.7.2013; nr.108, datë 3.10.2012; nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

25. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: "detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë" (....) "arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që

është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës" (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses, në drejtim të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses, lidhur me cenimin e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë haptazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Altina Xhoxhaj

Anëtarë pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me arsyetimin se pretendimet e saj janë haptazi të pabazuara. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, meqenëse nuk ndaj të njëjtin qëndrim me argumentet e përdorura prej saj, çmoj me vend të shprehem me mendim paralel.

2. Kërkuesja pretendon se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi gjykimi në apel është bërë në mungesë të saj dhe të Avokaturës së Shtetit, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e gjykimit nga ana e gjykatës. Ndërsa në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkuesja pretendon se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor për shkak të mosparaqitjes së arsyeve të mospranimit të rekursit.

3. Sikurse ka konstatuar edhe shumica, nga materialet e dosjes, rezulton se gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është zhvilluar në mungesë të kërkueses, ndonëse e njoftuar rregullisht. Në gjykim ka marrë pjesë Avokatura e Shtetit. Kundër vendimit të shkallës së parë kanë paraqitur ankim si Avokatura e Shtetit, ashtu edhe kërkuesja. Gjykata e Apelit ka publikuar datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit sipas dokumentit të listës së çështjeve të shpallura për gjykim të datës 19.9.2011. Avokatura e Shtetit nuk është njoftuar sipas nenit 79/a të KPC-së. Gjykimi në apel është bërë në mungesë të kërkueses dhe Avokaturës së Shtetit. Ndërsa në Gjykatën e Lartë ka paraqitur rekurs vetëm Avokatura e Shtetit (*shih paragrafët 19 – 20 të vendimit*).

4. Në këto kushte shumica, lidhur me këtë pretendim, ka çmuar se kërkuesja ka qenë në dijeni të zhvillimit të gjykimit në apel, nëpërmjet shpalljes së datës 19.9.2011 dhe interesat e saj janë përfaqësuar në shkallët e tjera nga Avokatura e Shtetit. Kjo e fundit, sipas ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë (neni 5/b). Si rrjedhojë, duke vlerësuar procesin si një të tërë, shumica ka arritur në përfundimin se, pretendimi i kërkueses është haptazi i pambështetur (*shih paragrafët 19 dhe 21 – 22 të vendimit*).

5. Lidhur me procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë shumica, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, ka argumentuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Sipas shumicës, sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

6. Lidhur me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit në gjykim, kjo Gjykatë, në vendimin nr. 27, datë 27.7.2009, ndër të tjera, është shprehur se: "Përderisa kishte pretendime nga secila palë për pronësinë mbi këtë sipërfaqe dhe përderisa përcaktimi i pozicionit të saj kishte lidhje me përcaktimin e pozicionit të trojeve të tjera, gjykatat duhet të vlerësonin pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas nenit 1, pika 3 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit".

7. Ndërsa në vendimin nr. 42, datë 29.9.2011, kur

është pretenduar se "Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit, duke shqyrtuar vetëm rekursin e Ministrisë së Drejtësisë", Gjykata ka theksuar se "Gjykata e Lartë ishte e detyruar të shprehej për rekursin e Avokaturës së Shtetit".

8. Për sa më sipër, edhe pse Avokatura e Shtetit ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, në ndryshim nga shumica, bazuar në jurisprudencën e kësaj Gjykate, çmoj se interesat që mbron një organ i administratës shtetërore dhe Avokatura e Shtetit, kur secili prej tyre është i pranishëm në proces, janë të ndryshme dhe nuk mund të plotësojnë njëri-tjetrin.

9. Jam i mendimit se ky është dhe *ratio* i ligjvënësit në formulimin e nenit 5/1/b të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit". Në të kundërt nuk do të kishte kuptim paragrafi i dytë i këtij neni, i cili pasi ka përcaktuar në paragrafin e parë të drejtën e përfaqësimit për Avokaturën e Shtetit, vijon (në paragrafin e dytë të tij) se "*në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës*". Nga interpretimi literal i këtij neni, vlerësoj se vetëm për raste të veçanta të mirëpërcaktuara Avokatura e Shtetit i delegon organit të administratës të drejtën e përfaqësimit. Në gjithë rastet e tjera, Avokatura e Shtetit duhet të marrë pjesë vetë në gjyq me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit, të cilat jo gjithmonë janë të njëjta me interesin e organit të administratës.

10. Në rastin në shqyrtim, në vlerësimin tim, përderisa Ministria e Mjedisit dhe Avokatura e Shtetit janë secila palë ndërgjyqëse të pranishme në proces, kërkuesja, Ministria e Mjedisit, nuk legjitimohet të ngrejë pretendime mbi mënyrën e njoftimit të akteve Avokaturës së Shtetit nga ana e gjykatës së apelit. Po ashtu duke qenë se Ministria e Mjedisit nuk ka ushtruar të drejtën e rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit, ajo nuk legjitimohet në pretendimet e saj lidhur me procesin në Gjykatën e Lartë. Si përfundim, mendoj se në këtë këndvështrim duhej të rrëzoheshin pretendimet e kërkueses.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i përket përfundimit të arritur në këtë çështje, në lidhje me pretendimet e cenimit: a) të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor; b) të drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

Në arsyetimin e saj shumica ka theksuar se, për sa u përket pretendimeve të kërkueses, në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre, në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues (*prg. 15 i vendimit*). Referuar pretendimit tjetër të kërkueses për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, shumica është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues. Duke pasur parasysh këtë standard dhe pas vlerësimit të procesit si një i tërë, ajo ka nënvizuar se në rastin konkret kërkuesja ka qenë në dijeni të zhvillimit të gjykimit në apel, nëpërmjet shpalljes së datës 19.9.2011 dhe interesat e saj janë përfaqësuar në shkallët e tjera nga Avokatura e Shtetit (*prg. 21-22 të vendimit*). Si përfundim, shumica i ka vlerësuar pretendimet e mësipërme të kërkueses si haptazi të pabazuara.

Nuk biem dakord me këtë qëndrim të shumicës për arsyet që vijojnë.

a) Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

Siç është shprehur edhe shumica, Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka vënë në dukje se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për

zgjidhjen e çështjes së themelit (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin konkret, kërkuesja dhe Avokatura e Shtetit, në ankimet e tyre drejtuar gjykatës së apelit, kanë parashtruar se: vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e një arsyetimi joligjor dhe një analize të përciptë e joobjektive të provave në gjykim. Sipas tyre, subjektet e interesuara nuk janë pronarë të të gjithë sendit por vetëm të objektit ekzistues, të njohur dhe të kthyer me vendimin nr. 153, datë 31.7.1995 të KKKP-së Tiranë, duke përjashtuar pjesën e re të objektit të ndërtuar nga shteti.

Në këndvështrim të shkaqeve të mësipërme, të ngritura në ankim, vërehet se gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses dhe Avokaturës së Shtetit duke cenuar, në vlerësimin tonë, barazinë e armëve gjatë gjykimit, si dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vendimi i gjykatës së apelit rezulton të ketë të njëjtën përmbajtje, si formale dhe substanciale, me vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nisur nga përputhshmëria identike e arsyetimeve të këtyre vendimeve gjyqësore si dhe mosdhënia përgjigje shkaqeve të ngritura, lind dyshimi objektiv se vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është kontrolluar nga gjykata e apelit.

GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj është shprehur se detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre nuk do të thotë dhënie përgjigje për çdo çështje/argument të ngritur nga pala për të mbështetur mbrojtjen e saj. Fushëveprimi/shtrirja e këtij detyrimi mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Për të respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, arsyetimi duhet të demonstrojë që gjyqtari/gjykata ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë ngritur përpara tij/saj (*shih çështjet Boldea kundër Rumanisë, 15 shkurt 2007 § 29 dhe Helle kundër Finlandës, 19 shkurt 1997, § 60*).

Në rastin konkret vërehet se, ndonëse gjykata e apelit është ndodhur para pretendimeve të ngritura për cenueshmërinë e arsyetimit, vlerësimin jo objektiv dhe të përciptë të fakteve dhe provave në gjykim, si dhe dëmshpërblimin e gabuar në lidhje me objektin e ri të ndërtuar nga kërkuesja, ajo nuk është shprehur në vendim për sa i përket këtyre pretendimeve.

Vërehet gjithashtu se, në rekurs, kërkuesja ka parashtruar sërish pretendime në lidhje me provat, konkretisht për: parregullsitë e aktit të ekspertimit, që është prova kryesore mbi të cilën është mbështetur gjykata; përllogaritjen e gabuar dhe jo në përputhje me pjesën ideale takuese të dëmshpërblimit për njërin prej subjekteve të interesuara (F.K.); referencën e ekspertit në gjendjen aktuale të objektit, pavarësisht se subjektet e interesuara nuk rezultojnë pronarë të pjesës së re të objektit të ndërtuar me shpenzimet e shtetit; abuzimin e ekspertit në përcaktimin e vlerës së qerasë. Ajo ka pretenduar se procesi ligjor i zhvilluar në gjykatat më të ulëta ka qenë i parregullt.

Megjithëse gjatë gjykimit në apel nuk është respektuar barazia e armëve dhe standardi i arsyetimit, siç është vlerësuar më sipër, vërejmë se këto shkelje, të pasqyruara në rekurs, nuk janë konstatuar nga Gjykata e Lartë, në ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe kontrollit për respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

Për sa më lart, nisur nga shkeljet e evidentuara gjatë gjykimit të apel dhe moskonstatimi i tyre nga Gjykata e Lartë, arrijmë në përfundimin se, në rastin konkret, nuk janë përmbushur kriteret e një vendimi të arsyetuar gjyqësor. Këto gjykata nuk kanë garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, ndaj në vlerësimin tonë, pretendimi i kërkueses për sa i përket cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar dhe duhej pranuar.

b) Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

Sipas kërkueses, gjykata e apelit nuk ka respektuar dispozitat procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate nuk është publikuar data dhe ora e gjykimit dhe nuk është respektuar neni 79/a të KPC-së, çka ka rezultuar në zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkueses dhe të Avokaturës së Shtetit.

Gjykata ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ato padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është tashmë një praktikë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës do të ishte pavlerë përshkrimi në detaje i garancive proceduriale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013 dhe nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i të drejtës në tërësi që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*)

Pavarësisht se kërkuesja ka pretenduar cenimin e të drejtës së aksesit, në vlerësimin tonë, ajo këtë të drejtë e ka ushtruar efektivisht duke paraqitur ankim në gjykatën e apelit. Nga rrethanat faktike rezulton se gjykimi në apel është zhvilluar në mungesë të kërkueses dhe të Avokaturës së Shtetit. Për gjykimin në apel kërkuesja ka pasur dijeni me shpallje, sipas listës së çështjeve të shpallura, të ndodhur në dosjen gjyqësore, ndërsa

Avokatura e Shtetit nuk është njoftuar për këtë gjykim. Në bazë të nenit 5/1 shkronja "b" të ligjit 10018/2008, Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Për institucionet dhe për çështjet juridike të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, asistenca juridike e Avokaturës së Shtetit është e detyrueshme. Përfaqësimi dhe mbrojtja e detyrueshme e pronës dhe interesave publike nga ana e Avokaturës së Shtetit, në një gjykim të filluar gjen mbështetje edhe në Vendimin Unifikues nr. 13, datë 24.3.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykatat, sipas nenit 79/a të KPC-së, kanë detyrimin që t'i njoftojnë aktet Avokaturës së Shtetit, me qëllim që kjo e fundit jo vetëm të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen e interesave të shtetit (*shih vendimet nr. 42, datë 29.9.2011 dhe nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Gjykata e Lartë, në vendimin unifikues nr. 13/2004, është shprehur se neni 79/a i KPC-së imponon detyrimin për gjykatën që, kur shqyrton çështje për të cilat përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, të urdhërojë njoftimin e akteve kësaj të fundit. Pra, në këtë kuptim, njoftimi i akteve Avokaturës së Shtetit nuk është qëllim në vetvete, por bëhet në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit. Nëse interesat e shtetit janë përfaqësuar dhe mbrojtur efektivisht gjatë gjykimit është një vlerësim që duhet bërë rast pas rasti.

Në rastin konkret, rezulton se Avokatura e Shtetit nuk është njoftuar sipas nenit 79/a të KPC-së nga gjykata e apelit. Për më tepër, vëmë në dukje se, ndryshe nga sa është shprehur gjykata e apelit në procesverbalin e datës 13.10.2011, Avokatura e Shtetit nuk është njoftuar as me shpallje. Në listën e çështjeve të shpallura të datës 19.9.2011, si palë është vendosur në sistem vetëm Ministria e Mjedisit. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit nuk e ka plotësuar standardin e njoftimit duke mos i dhënë për pasojë mundësinë Avokaturës së Shtetit për t'u dëgjuar dhe për të mbrojtur interesat publike. Gjykata e apelit duhet të vlerësonte pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas ligjit nr. 10018, datë 23.11.2008, ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Njoftimi i Avokaturës së Shtetit merr akoma dhe më tepër rëndësi në rastin konkret, duke pasur parasysh se interesat e shtetit nuk janë përfaqësuar e mbrojtur gjatë gjykimit në apel për shkak të zhvillimit të këtij gjykimi në mungesë të kërkueses dhe Avokaturës së Shtetit. Rrjedhimisht, bazuar në arsyetimin e mësipërm, çmojmë se mosrespektimi i dispozitave procedurale të njoftimit, që pretendohet nga kërkuesja, lidhet me cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur e përfaqësuar në gjykim. Në vlerësimin tonë, ky pretendim është i bazuar dhe duhej pranuar.

Si përfundim, vlerësojmë se, në rastin konkret, pretendimet në drejtim të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në gjykim, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara. Për pasojë, kërkesa duhej pranuar dhe vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë duheshin shfuqizuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha[1]

[1] Gjyqtari Fatmir Hoxha i është bashkuar mendimit të pakicës vetëm për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.